



Solli dhe përshtati në shqip: Mirela Leka Xhava, Francë

Chris Talazac lindi në Saint-André-de-Lidon në Charente-Maritime, Francë. Ajo është poetë dhe themeluese e faqes së internetit dhe revistës së njohur letrare online Le Monde de Poetika dhe faqes tjetër të internetit PoetikArts. Autore e disa përmbledhjeve me poezi dhe haiku, ajo është botuar në disa nga gazetat dhe revistat më të famshme të Francës. Ajo ka fituar çmime të shumta konkurruese në Francë që nga viti 1998 dhe gjithashtu ka kontribuar në antologji të shumta. Ajo është anëtare e Shoqatës Les Poètes de l'Amitié - Poètes sans frontières që nga viti 2021.

Kësaj here vjen me një cikël poezish lirike dhe haiku.

1

## Të shkruaj...

Rilexoi një nga një  
Këto perla mbrëmjeje  
Që vezullojnë nën hënë  
Dhe në kujtesën time mbeten.

Të shkruaj...  
Merr frymë në këto faqe  
Në prehrin e vjeshtës sonë  
Se nën fleta dhe gjethnjaj  
Dridhet fshehtësia jonë.

Të lutem...  
Bashkoi me këto rima  
Tingujt e ngrohtë të kitarës tënde  
Në duetet tona intime  
Ku shikimet tona luajnë butë.

Të krijoj...  
Vallëzimeve, rrotullimeve  
Në ritmin e zërit tënd të pastër  
Në valët e mia, në frymëmarrime  
Ti i merr të gjitha.

E pastaj...  
Mos harro gjurmët që lë  
Pikat, shenjatat, çdo shenjtim  
Kur rrëshqas e kaloj pa zë  
Nëpër këto rreshta që flasin.

Dhe prapë...  
Ribashkuar një nga një  
Këto gjurmë të natës  
Këto perla të dritës së hënës (që s'janë si më parë)  
Në një lumë shprese pa fjalë.

2

## Stuhia

Thellë në Provence, dëgjo erën e verës  
Që përfsihin në zemër çmendurinë e gjinkallave.  
Shiko si shkëlqejnë sonte kisha dhe këmbanarja  
Në majën e fshatit tim, të varur tek vjet.

# VALLJA E SHIUT

Poezi nga Chris Talazac, Francë



Shko përpara dhe shiko përsëri në buzë të dritares  
Velat e varkave të bardha që tashmë po largohen,  
Duke skicuar disa rrrathë përpara se të zhduken  
Nën horizontin e botës që rrumbullakoset atje poshtë.

Një stuhë shumë e fortë trondit gjithë bregun.  
Një përrua fryhet dhe shkon drejt një ferme të fjetur.  
Dëgjo më larg breshrin që shpon gjethet,  
Dhe rrufenë e dhunshme që shqyen qiellin.

E dua aromën e rëndë dhe të lagësht të livandës  
Që depërton në dhomë në natën e zemëruar.  
Mbylli krahët rreth duarve të mia të dorëzuara,  
Më frymo sërish deri në fund të detit.

Mos thuaj asgjë, unë e di, do të ketë nesër.  
Ngatërrimë mua, më shpjer në një valle të çmendur,  
Mes valëve të mia, zëri yt, ëmbëlsia e lidhjeve tona  
Të cilat rrjedhin lirshëm midis dy ritmeve.

Çmimi i parë i Agimit të poetëve  
Konkursi i 10-të Ndërkombëtar CEPAL  
Saint-André-lez-Lille (Nord)

3

## Vallja e shiut

Era pëshpërit  
Si një tufëz  
Shiu godet me shuplakë  
Në kopësht.

Ai bie  
Dhe pastaj rrjedh

Në hendekun  
Që po zgjohet

Mbrëmja është blu  
Si livando  
Që kërcen paksa  
Në buzë të moçaleve.

Të gjitha lulet  
Janë të përmbysura  
Dhe në zemrën time  
Gjithçka është e lagur.

Çmimi d'Honneur  
Esnafi i Poezisë  
Evreux (Eure)

4

## Unë dua të ëndërroj më tej

Unë dua të ëndërroj më tej  
Për të mos numëruar më, për të dhënë  
Të mos dridhen, të flas  
Për të mos bërtitur  
Të frymoj  
Të shpresoj  
Të ndaj me të tjerët.

Në fillimet e kësaj pranvere të ftohtë  
Midis oqeanit dhe faqeve të kodrave, vreshtave dhe kënetave  
Netët e mia janë këtu  
Ditët e tua janë atje  
Dhe anasjelltas  
Ka netë të tilla  
Në vetminë time prej zanash  
Aty ku asgjë nuk funksionon më  
Aty ku minutat vlejnë po aq sa krahët e tu  
Por krahët e tu nuk ekzistojnë  
I them vetes se zana e yjeve  
Nuk bën më për mua  
Që po harxhoj kot bojën dhe xixëllimet e mia  
I them vetes kaq e kaq shumë gjëra  
Kaq shumë trëndafila gëzimi.

## Haiku

1  
Era duke fryrë  
mbi gjethnjajën e vjeshtës  
Pylli i zhveshur.

2  
Far i palëvizshëm  
duke gëlltitur retë  
ashtu qetësisht.

3  
Në pik të verës,  
larg skelës, duke u nis  
të ngrejë velat.

4  
Varka kalon gjirin  
me të gjitha velat  
të hapura.

5  
Një pulëbardhë gri  
ngjitet pas kangjellave  
shkon rrotullimthi.